

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
VITI 2024**

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	13.02.2024	Kërkohen të dhëna financiare, raporte dhe korrespondenca mbi menaxhimin e kompanisë “Integrated Energy” BV SPV të prodhuara nga administratori i pasurisë së sekuestruar nga Gushti 2023 deri më sot konkretisht: 1.Të gjitha dokumentet e prodhuara nga administratori publik mbi gjendjen financiare të shoqërisë të tilla si analiza financiare të shoqërisë?	29.02.2024	<p>Në përgjigje të shkresës suaj të datës 08.02.2024, (protokolluar në AAPSK me nr. 581, datë 13.02.2024), ku kërkohen të dhëna financiare, raporte dhe korrespondenca mbi menaxhimin e kompanisë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k., ju bejme me dije se informacioni public, pasqyrat financiare, raporti i auditimit per vitin 2022 gjenden te publikuara ne regjistrin public te Qendres Kombetare te Biznesit dhe ky informacion eshte i aksesueshem nga publiku.</p> <p>Në zbatim të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, shoqëria “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k. do te publikoje pasqyrat financiare, raportin e auditimit sipas afateve ligjore që ligji Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” përcakton.</p> <p>Bazuar në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, neni 17 pika 2 gërma b citon: “ E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe</p>	Me shkresë zyrtare	Pa pagesë

	<p>2. Bilancin, pasqyrat financiare për vitin 2022 dhe 2023.</p> <p>3. Korrespondenca e shkëmbyer mes administratorit Arjan Baci dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për çështje që lidhen me menaxhimin e landfillit të Sharrës nga gushti 2023.</p> <p>4. Sasia e mbetjeve të depozituara në landfill nga bashkitë përkatëse për vitet 2018-2023 dhe kapacitetet aktuale të landfillit.</p> <p>5. Raporte auditimi të pasqyrave financiare, nëse keni.</p>		<p><i>nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:</i></p> <p><i>b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale”.</i></p> <p>Referuar faktit që shoqëria për të cilën ju kërkoni informacion është shoqëri me masë sigurimi “sekuestro preventive” dhe dokumentacioni i shoqërisë njëkohësisht konsiderohet provë materiale ku po i nënshtrohet dhe proceurave hetimore sipas vendimit nr. 95, datë 28.07.2023 të Gjykatës së Posacme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ndodhur në këto kushte vlerësojmë mirëkuptimin tuaj që informacione të vecanta dhe të detajuara nuk mund të jepen në interes të ruajtjes së provave deri në përfundimin e procesit hetimor nga SPAK.</p>	
--	--	--	--	--

2	15.10.2024	<p>1- Një kopje të listës së pasurive të sekuestruara dhe të dhëna me qira tek persona fizik ose subjekteve të ndryshme nga viti 2015- tetor 2024.</p> <p>2- Një kopje të kontratës së qirasë së lidhur të pasurive të sekuestruara me personat fizik ose subjekteve të ndryshme nga vitit 2015- tetor 2024.</p> <p>3- Një kopje të procesverbaleve të mbajtur për ankandet e zhvilluara për shitjen e pronave të konfiskuara nga viti 2015-2020.</p> <p>4-Një kopje të kontratës së shitjes së pasurive te konfiskuara nga ankandet e zhvilluara nga vitit nga viti 2015-2020</p> <p>5- Një kopje të</p>	05.11.2024	<p>1)Në përgjigje të kërkesës suaj datë 15.10.2024 protokolluar tek ne me nr.5081 datë 15.10.2024, ju informojmë si më poshtë:</p> <p>AAPSK po zhvillon aktualisht një inventarizim të plotë të pasurive/pronave të sekuestruara dhe konfiskuara, si edhe hedhjen e të dhënave në databazën përkatëse/regjistrin e pasurive.</p> <p>Për sa i përket kontratës së shitjes së pasurive të konfiskuara nga ankandet e zhvilluara që prej vitit 2015-2020, ju bëjmë me dije se Agjencia nuk zhvillon ankande publike për shitjen e pasurive të konfiskuara me vendim të formës së prerë, por vetëm përgatit dosjen për t'ia përcjellë Drejtorisë së Përgjithshme të Shitjes së Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave.</p> <p>Procedura për shitjen e pasurive të konfiskuara zhvillohet nga Drejtoria e Shitjes së Pronës Publike dhe ankandi është publik. Pasuritë të cilat janë destinuar për tu shitur nëpërmjet ankandit publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.</p> <p>Referuar Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 888/2020 "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERESIMIT, MËNYRAT DHE PROCEDURAT E DHËNIES NË PËRDORIM DHE TË</p>	<p>Me shkresë</p> <p>Zyrtare dhe</p> <p>Email zyrtar.</p> <p>-E plotë.</p>	Pa pagesë.
---	------------	---	------------	--	--	------------

		<p>kërkesë me shkrim të bërë nga personat e interesuar për blerën e pasurive të konfiskuara në ankandet e zhvilluara nga viti 2015- 2020.</p> <p>6- Një kopje të mandat pagesës apo Garancinë bankar që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit secilit pjesëmarrës, për llogari të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, nga ankandet e zhvilluara nga viti 2015-2020</p> <p>7- Një kopje të deklarimit personal të secilit pjesëmarrës, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi,</p>		<p>TJETËRSIMIT TË PASURIVE TE KONFISKUARA", Kreu V përshkruan të gjithë procedurën ligjore që zhvillohet për shitjen e pasurive me ankand.</p> <p>Konkretisht pika 1): "Shitja e pasurive të konfiskuara bëhet me ankand publik, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, <i>"Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transferohet dhe procedurat e shitjes"</i>, të ndryshuar. Procedura e ankandit kryhet nga struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike pranë ministrisë përgjegjëse për financat dhe ekonominë. Në komisionin e ankandit merr pjesë edhe një përfaqësues i AAPSK-se, si anëtar".</p> <p>Kreu V pika 8): <i>" Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike pranë ministrisë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, pasi ka pranuar dokumentet e vlerësimit të objektit, ndërmerr hapat përkatës për botimin e njoftimit për shitje të objektit, si më poshtë vijon: a) botimin e listës së objekteve, që do të shiten dhe shpalljen e kësaj liste në fagen e internetit të ministrisë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, me të dhënat për çdo objekt; b) struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë dërgon pranë AAPSK-së njoftimin për zhvillimin e ankandit me të dhënat përkatëse; c) brënda afatit të</i></p>		
--	--	--	--	--	--	--

		<p>sipas dispozitave të ligjit Nr. 10192, datë 03.12.2009, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 34/2019, të ndryshuar, për pjesëmarrësit në ankandet e zhvilluara nga viti 2015-2020.</p>		<p><i>publikimit, AAPSK-ja dërgon zyrtarisht procesverbalin e vendosjes së afisheve në strukturën përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë".</i></p> <p>Pika 14): " Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin në vendin, datën dhe orën e njoftuar, në komisionin e ankandit, këto dokumente: a) kerkesën me shkrim për blerjen e objektit; b) garancinë bankare (apo mandatpagesën) që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të AAPSK-së; c) deklarinimin personal të secilit pjesëmarrës, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr.10192, date 3.12.2009, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar".</p> <p>Sa me sipër, AAPSK nuk administron dokumentacionin e sipërcituar, pasi ky i fundit paraqitet pranë komisionit të ankandit.</p> <p>Po ashtu, procesverbalet për zhvillimin e ankandeve mbahen nga komisioni i ankandit.</p> <p>Kreu V, pika 25): "Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, pas pagesës së vlerës së plotë të objektit, është e detyruar ta lidhë kontratën e shitjes ndërmjet palës shitëse (përfagesuesi i strukturës</p>		
--	--	---	--	--	--	--

			<p><i>përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë dhe përfaqësuesi i AAPSK-së dhe blerësit privat”.</i></p> <p>2) Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 15.10.2024 protokolluar tek ne me nr.5058 datë 15.10.2024 ju informojmë si më vijon:</p> <p>Pasuria me nr.24/142, vol.21, fq.31 zk.8512 e llojit truall me sipërfaqe 2498.7 m2 dhe ndërtesa 1129.39 m2 është pasuri e konfiskuar me vendim të formës së prerë.</p> <p>Kërkesat me shkrim të bera nga të interesuarit për blerjen e kësaj pasurie janë kërkesa të cilat nuk administrohen nga AAPSK, por nga strukturat përgjegjëse për shitjen e pronës publike pranë Ministrisë së Ekonomisë.</p> <p>Po ashtu, mandatpagesat për ngurtësimin e 20 % të vlerës fillestare të ankandit si dhe deklaratat e konfliktit të interesave të secilit pjesëmarrës janë dokumente të cilat paraqiten para komisionit i cili zhvillon ankandin.</p> <p>Për kopjen e procesverbalit të mbajtur në lidhje me ankandin e zhvilluar më datë 04.07.2023 duhet t'i drejtoheni strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike.</p>	
--	--	--	--	--

				<p>3) Në përgjigje të kërkesës datë 15.10.2024 proktokolluar tek ne me nr.5082 datë 15.10.2024 ju informojmë si më poshtë:</p> <p>Për periudhën 2023-2024, nuk është zhvilluar asnjë procedurë ankandi për shitjen e pasurive të konfiskuara.</p> <p>Lidhur me kërkesat tuaja sipas pikave 1 dhe 2-5 nr rendor, kërkesat me shkrim të bëra nga të interesuarit për blerjen e kësaj pasurie janë kërkesa të cilat nuk administrohen nga AAPSK por nga strukturat përgjegjëse për shtjen e pronës publike pranë Ministrisë së Ekonomisë.</p> <p>Po ashtu, mandatpagesat për ngurtësimin e 20 % të vlerës fillestare të ankandit si dhe deklarata e konfliktit të interesave të secilit pjesëmarrës janë dokumente të cilat paraqiten para komisionit i cili zhvillon ankandin.</p> <p>Për sa më sipër, informacioni kërkuar lidhur me procedurat e shitjes së pasurive të konfiskuara administrohet plotësisht nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

3.	08.02.2024	<p>1.Të gjitha dokumentacionet e prodhuara nga administratori public mbi gjendjen financiare të shoqërisë si analiza financiare, inventare, raporte mbi shpenzimet e kryera për investime apo borxhe të mundshme të akumuluar.</p> <p>2.Bilanci, pasqyra financiare dhe shënime të tera shpjeguese për vitin 2022-2023.</p> <p>3.Korrespondenca e shkëmbyer mes administratorit A.Baci dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për çështjet apo problematika që lidhen me menaxhimin e landfillit të Sharrës nga gushti 2023 deri më sot.</p>	29.02.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj datë 08.02.2024 protokolluar tek ne me nr.581 datë 13.02.2024, ku kërkonti të dhëna financiare, raporte dhe korrespondenca mbi menaxhimin e kompanisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, ju bëjmë me dije se informacioni pubik, pasqyrat financiare, raporti auditimit për vitin 2022 gjënden të publikuara në regjistrin publik të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe ky informacion është i aksesueshëm nga publiku. Në zbatim të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, do të publikojë pasqyrat financiare, raportin e auditimit sipas afateve ligjore që ligji Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" përcakton. Bazuar në ligjin nr.119/2014 Neni 17 pika 2 gërma b " Për të drejtën e informimit" citon: "E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm; b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale"; Referuar faktit që shoqëria për të cilën ju kërkonti informacion është shoqëri me masë sigurimi "sekuestro preventive" dhe dokumentacioni i shoqërisë njëkohësisht konsiderohet provë materiale ku po i nënshtrohet dhe procedurave hetimore sipas vendimit nr.95 datë 28.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar,</p>	Me shkresë Zyrtare.	Pa Pagesë
----	------------	---	------------	--	----------------------------	-----------

		<p>4.Sasia e mbetjeve të depozituara në landfill nga bashkitë përkatëse për vitet 2018-2023 dhe kapacitetet aktuale të landfillit.</p> <p>5. Raporte auditimi të pasqyrave financiare, nëse keni.</p>		<p>ndodhur në këto kushtë vlerësojmë mirëkuptimin tuaj që informacione të vecanta dhe të detajuara nuk mund të jepen në interes të ruajtjes së provave deri në përfundimin e procesit hetimor nga SPAk</p>		
4-5	09.05.2024 dhe 04.09.2025	<p>09.05.2024- Kerkohet informacion dhe për vënie në dispozicion të dokumenteve zyrtare lidhje me blerejen apo marrjen me qira të pasurisë së konfiskuar të shtetasit Denis Metoshi alias Eldi Dizdari. Më datë 29.05.2024 Gjykata e Posaçme e Apelit për</p>	01.10.2024	<p>E nderuar znj. Xhaferri, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) në veprimtarinë për përmbushjen e përgjegjësisë institucionale, bazohet në parimet e mirëadministrimit, efektivitetit, efikasitetit, ekonomicitetit, transparencës, të ligjshmërisë të pasurive që ka në administrim.</p> <p>Në përgjigje të shkresës suaj më datë 09/05/2024, protokolluar me nr. 4612 datë 11.09.2024 dhe shkresës datë 04/09/2024, protokolluar me nr. 4613 datë 11.09.2024, ku keni kërkuar vënien në dispozicion të dokumentave dhe të informacioneve zyrtare në</p>	Me shkresë zyrtare	Pa pagesë.

		<p>Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr.100, ka vendosur lënien në fuqi të vendimitnr. 34, të datës 22.12.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për konfiskimin e pasurisë së Denis Metoshës alias Eldi Dizdari. Më konkretisht konfiskimi është bërë për këto pasuri: Pasuria e llojit "Njësi", e ndodhur në Zona Kadastrale nr.8160, Rruga "Bajram Curri", Tiranë, me sip. totale 198.1 m2, në pronësi të shtetasit Denis Matoshi;</p>		<p>lidhje me blerjen apo marrjen me qira të pasurive të konfiskuara të shtetasit Arben Isufaj (Ben Qimja) dhe shtetasit Denis Matoshi alias Eldi Dizdari, ju informojmë si më poshtë:</p> <p>a) Për pasuritë e konfiskuara ndaj shtetasit Denis Matoshi alias Eldi Dizdari, bëjmë me dije se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Pasuria e llojit "Garazh" me nr. pasurie 2/276-G32, Vol. 38, fq. 243 e ndodhur në z.k. 8160, Rruga "Bajram Curri", Tiranë, me sipërfaqe totale 14.3m', në pronësi të shtetasit Denis Matoshi;</i> ➤ <i>Pasuria me nr. 10/349+1-56, vol.22, Fq. 57, e ndodhur në z.k. 8310, Rr. "Gjergi Legisi", Tiranë, e llojit "Apartament" me sipërfaqe totale 65.32 m', në pronësi të shtetasit B.Sh.;</i> <p><i>Shuma e parave prej 40,000 euro, ndodhur në llogarinë e Gj.K, pranë bankës P... Bank, derdhur nga shtetasi A.M., sipas veprimit bankar transfertë e brendshme personale, datë 08.11.2021, sipas kontratës së shitjes me nr.5511 Rep.r.2280 Kol. datë 08.11.2021 për pasurinë me nr. 10/349+1-57, Vol. 22, Fq. 58, e ndodhur ne z.k. 8310,</i></p>		
--	--	--	--	---	--	--

		<p>Pasuria e llojit "Garazh", e ndodhur në Zona Kadastrale nr.8160. Rruga "Bajram Curri". Tiranë, me sip. totale 14.3m², në pronësi të shtetasit Denis Matoshi;</p> <p>Pasuria e llojit "Truall", me sipërfaqe 5269 m², Zona Kadastrale nr.8160, rruga "Dervish Hima", Tiranë, pjesa takuese 2163/30000, në pronësi të shtetasit Denis Matoshi, pasuri që është në bashkëpronësi.</p> <p>Të drejtën e shtetasit Denis Matoshi, për të përfituar vlerën e shpronësimit nga Komisioni Posaçëm për</p>		<p><i>Rr. "Gjergj Legisi", Bashkia Tiranë, e llojit "Apartament" me sipërfaqe totale 58.88m', në bashkëpronësi të shtetasve S.Sh. dhe B.Sh. Shuma prej 40,000 euro ka kaluar në favor të shtetit.</i></p> <p>Për pasuritë me nr. 1 dhe nr. 2 është ekzekutuar masa e konfiskimit në muajin gusht 2024. Aktualisht jemi në pritje të finalizimit të procedurës, kalimit në favor të shtetit të pasurisë së konfiskuar (<i>pajisjen me certifikatë pronësie, kartelë pasurie, hartë treguese</i>).</p> <p>Mbi pasuritë për të cilat subjekti ka përfituar vlerën e shpronësimit bazuar në korespondencën zyrtare, si përfitues të ligjshëm sipas vendimit gjyqësor, jemi në pritje të transferimit të vlerës së shpronësimit për pasuritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Pasuria e llojit "Truall", me nr. pasurie 6/438 me sipërfaqe 5269 m', Zona Kadastrale 8160, Rr. "Dervish Hima" Tiranë, pjesa takuese 2163/30000 në pronësi të shtetasit Denis Naim Matoshi, pasuri që është në bashkëpronësi;</i> 		
--	--	---	--	---	--	--

		<p>Shpronësim për shpronësimin në pasurinë me nr. 6/380, Zona Kadastrale nr.8160, rruga "Dervish Hima", si bashkëpronar në këtë pasuri në pjesë takuese 120005/1680000, me vlerë paraprake të shpronësimit 8.180.125.82 lekë.</p> <p>Shuma e parave prej 40 000 (dyzetë mijë) Euro, ndodhur në llogarinë bankare të noterit;</p> <p>Pasuria e ndodhur në Zona Kadastrale nr.8310, Rruga "Gjergj Legisi". Tiranë, e llojit "Apartament" me sip. totale 65.32m2, në</p>		<p>➤ <i>Të drejtën e shtetasit Denis Matoshi për të përfituar vlerën e shpronësimit nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësim, për shpronësimin në pasurinë me nr. 6/380, z.k. 8160, rruga "Dervish Hima" si bashkëpronar në këtë pasuri në pjesë takuese 120005/1680000 me vlerë paraprake të shpronësimit 8,180,125.82 lekë.</i></p> <p>Në zbatim të vendimit gjyqësor nuk është bërë mundur ekzekutimi i masës së konfiskimit për pasurinë:</p> <p>➤ <i>Pasuria e llojit "Njësi" me nr. pasurie 2/276-N117, Vol. 39, Fq. 153 e ndodhur ne ZK. 8160, Rruga Bajram Curri, Tirane, me sipërfaqe totale 198.1m2.</i></p> <p>Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, jemi duke bashkëpunuar për ekzekutimin e masës së konfiskimit të vendosur ndaj kësaj pasurie.</p> <p>Në pritje të dokumentacionit pronësor të rifreskuar, me pronar Republika e Shqipërisë, do të vijohet përgatitja e raportit tekniko-financiar, me qëllim përcjelljen e këtyre pasurive të konfiskuara për destinim, sipas</p>		
--	--	---	--	---	--	--

		<p>pronësi të shtetasit B.Sh.</p> <p>Pyetjet tona janë: Në çfarë faze ndodhen pronat e Eldi Dizdarit alias Denis Metoshi? Ju lutem, listojeni.</p> <p>Kush po administron aktualisht secilin objekt të konfiskuar të shtetasit Eldi Dizdari alias Denis Matoshi? Ju lutem, na vendosni ne dispozicion dokumentat e nevojshme te administrimit.</p> <p>A është realizuar akandi për marjen me qira apo blerjen e këtyre pronave? Ju lutemi, na vendosni në dispozicion një kopje të</p>		<p>vendimit që do të marrë Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar. Njëkohësisht, bëjmë me dije se nuk është destinuar asnjë nga pasuritë e sipërcituara për shitje.</p> <p>b) Lidhur me pasuritë e konfiskuara të shtetasit Arben Isufaj, bëjmë me dije se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Në lidhje me shoqërinë "ISUFAJ 2001", me nipt K23019402P si dhe për shoqërinë "AKILI ALB" shpk, me nipt L12805404G, nga verifikimet që në fazën e sekuestros me Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, rezulton se gjendja e shoqërive është pasive dhe konkretisht, subjekti "ISUFAJ 2001", me nipt K23019402P ka qënë pasiv që prej vitit 2007 në sistemin CATS, cituar dhe në vendimin gjyqësor ndërsa subjekti "AKILI ALB" shpk, me nipt L12805404G është pezulluar që në datën 10/09/2021. ➤ Për pasurinë e llojit "Truall", me sipërfaqe 3,289 m2, e cila ndodhet në Fier, është bërë kërkesë për ekzekutim vendimi Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Fier mbi vijimin e procedurave për kalim e pronësisë shtet 		
--	--	--	--	---	--	--

		<p>dokumentacionit të mbajtjes së akandit me procedurën e plotës të tij, duke përfshirë të gjithë ofruesit.</p> <p>Cilat pasuri janë marrë me qira dhe cilat janë blerë? Ju lutem, vendosi në dispozicion një kopje të kontratës së marrjes me qira, ose të blerjes duke censuruar të dhënat tregtar, aty ku aplikohen.</p> <p>Cila ka qenë vlera fillestare për çdo pasuri të shtetasit Eldi Dizdari alias Denis Matoshi, që është konfiskuar nga shteti shqiptar? Ju lutem, listojini për çdo pasuri duke na vendosur ne dispozicion</p>		<p><i>dhe lëshimet e fragmenteve hartës treguese, kartelës dhe certifikatës për këtë pronë.</i></p> <p>Për pasurinë e paluajtshme të llojit "Tokë pa Frut", me sipërfaqe 14,000 m², si dhe pasurinë e paluajtshme e llojit "Arë", me sipërfaqe 1,467 m², e cila ndodhet në Sheq i Madh, Fier janë ndjekur të gjitha procedurat e administrimit dhe është e gatshme për destinim referuar procesit të administrimit nga të tretët. Këto pasuri janë publikuar për tu dhënë me qira, por ende nuk ka pasur asnjë shfaqje interesi.</p> <p>Për këto pasuri është hartuar raporti tekniko-financiar dhe janë të gatshme për destinim, sipas vendimit të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar.</p> <p>Sa u përket pasurive të luajtshme të llojit automjete nga ana e AAPSK-së është marrë në administrim vetëm pasuria e llojit automjet "Mercedes Benz" S63 AMG, me targë AA 009 PU. Referuar procedurave të destinimit të pasurive të konfiskuara, me vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar kjo pasuri ka kaluar në përgjegjësi administrimi "kalim kapitali pa pagesë" në favor të Drejtorisë së</p>		
--	--	--	--	--	--	--

		<p>dokumentat e nevojshme.</p> <p>Cilët janë fituesit e akdandit për secilën pasuri të Eldi Dizdari alias Denis Matoshi?</p> <p>Cila ka qenë vlera fituese për çdo pasuri të Eldi Dizdari alias Denis Matoshi në ankand?</p> <p>-04.09.2024 Kerkohen te dhena dhe vënie në dispozicion të dokumenteve/informacioneve zyrtare lidhje me blerejen apo marrjen me qira të pasurisë së konfiskuar të shtetasit Arben Isufaj (Ben Qimja). Konkretisht, me vendimin numër 7 të datës 30.01.2023,</p>		<p>Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pasuri të tjera janë shpallur në kërkim nga Policia e Shtetit.</p>		
--	--	---	--	--	--	--

	<p>Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, ka vendosur konfiskimin e kësaj pasurie të shtetasit Arben Isufaj (Ben Qimja).</p> <p>1. Objekt "Pulari", shoqëria tregëtare, emërtuar "ISUFAJ 2001", me NIPT. K23019402P, i përbërë nga 1 godinë, me objekt të aktivitetit "Rritje dhe tregëtim të zogjve të pulës, me shumicë e pakicë", cili ndodhet me seli në fshatin Grize-Patos.</p> <p>2. 33% e kuotave të kapitalit të</p>				
--	---	--	--	--	--

	<p>Shoqërisë "AKILI ALB" SHPK, me Nipt.L12805404G i regjistruar më datë 05.04.2011.</p> <p>3. Një pasuri të paluajtshme e llojit "Truall", me sipërfaqe 3,289.00 m2, e cila ndodhet në Fier.</p> <p>4. Një pasuri të paluajtshme e llojit "Tokë pa Frut", me sipërfaqe 14000 m2, e cila ndodhet në Hasturkas-Fier.</p> <p>5. Një pasuri të paluajtshme e llojit "Arë", me sipërfaqe 1467 m2, e cila ndodhet në Sheq i Madh- Fier;</p> <p>6. Automjeti AUTOVETURE, marka/tipi/emërtim i AUDI A8, në pronësi të E. Isufaj</p>			
--	---	--	--	--

	<p>7. Automjeti AUTOVETURE, marka/tipi/emërtim i MERCEDES BENZ ML270CDI, në pronësi të Y Isufaj.</p> <p>8. Automjeti lloji AUTOVETURË, marka/tipi/emërtim i MERCEDES BENZ 300D, në pronësi të Y. Isufaj.</p> <p>9. Automjeti lloji AUTOVETURË, marka/tipi/emërtim i DAIMLER CHRYSLER S500, në pronësi të A. Çako.</p> <p>10. automjeti lloji AUTOVETURË, marka/tipi/emërtim i MERCEDES BENZ S63 AMG, me numër shasie DD2211771A2784</p>				
--	---	--	--	--	--

	<p>11, ngjyrë Gri, në pronësi A. Çako.</p> <p>11. automjeti me targë AA721OB, lloji AUTOVETURË, marka/tipi/emërtim i AUDI A8L, në pronësi të A. Çako.</p> <p>Pyetjet tona janë: Në çfarë faze ndodhen secilat nga pronat e Arben Isufaj (Ben Qimja)? Ju lutem, listojeni.</p> <p>Kush po administron aktualisht secilin objekt të konfiskuar të shtetasit Arben Isufaj (Ben Qimja)? Ju lutem, na vendosni ne dispozicion dokumentat e nevojshme.</p>				
--	--	--	--	--	--

		<p>A është realizuar akandi për marrjen me qira apo blerjen e këtyre pronave? Ju lutemi, na vendosni në dispozicion një kopje të dokumentacionit të mbajtjes së akandit me procedurën e plotës të tij, duke përfshirë të gjithë ofruesit.</p> <p>Cilat pasuri janë marrë me qira dhe cilat janë blerë? Ju lutem, vendosi në dispozicion një kopje të kontratës së marrjes me qira, ose të blerjes duke censuruar aplikohen.</p> <p>Cila ka qenë vlera fillestare për çdo pasuri shtetasit Arben Isufaj (Ben Qimja), që është</p>				
--	--	--	--	--	--	--

		<p>konfiskuar nga shteti shqiptar? Ju lutem, na vendosni ne dispozicion dokumentat nevojshme për çdo pasuri.</p> <p>Cilët janë fituesit e akadandit për secilën pasuri të Arben Isufaj (Ben Qimja)? Ju lutem na vendosni ne dispozicion dokumentat e nevojshme të akandit.</p> <p>Cila ka qenë vlera fituese për çdo pasuri të Arben Isufaj (Ben Qimja) në ankand? Ju lutem na vendosni ne dispozicion dokumentat e nevojshme të akandit.</p>				
--	--	---	--	--	--	--

6.	20.09.2024	<p>Dallandyshe Xhaferri dhe Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri, ju lutet institucionit tuaj për vënie në dispozicion të dokumenteve/informacioneve zyrtare në lidhje me çështjen referuar në kërkesën bashkangjitur këtij email-i.</p> <p>Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetem në pritje të përgjigjes suaj!</p> <p>Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të më kontaktoni edhe në numrat</p>		<p>E nderuar znj. Xhaferri,</p> <p>Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) në veprimtarinë për përmbushjen e përgjegjësive institucionale, bazohet në parimet e mirëadministrimit, efektivitetit, efikasitetit, ekonomicitetit, transparencës, të ligjshmërisë të pasurive që ka në administrim.</p> <p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj, ku keni kërkuar vënie në dispozicion të dokumentave dhe të informacioneve zyrtare në lidhje me blerjen apo marrjen me qera të pasurive të konfiskuara të shtetasit Emiljano Shullazi</p> <p>Pjesa e pandarë (ideale) e pasurisë nr.24/142,vol.21,faqe31, zk.8512 truall me sip. 2498.7 m2, dhe ndërtesë 1129.39m2 në Durrës, në bashkëpronësi të Fejzi Kodra, Marjeta Kodra, Emiljano Shullazi, pjes e regjistruar në favor të këtij të fundit më datë 15.12.2014, mbi transkriptimin e kontratës së dhurimit nr.2897 rep/1416 kol, datë 09.12.2014 dhe aneks kontratës së dhurimit nr.2938 rep/1433 kol, datë 14.12.2014.</p> <p>Ekzekutimi është kryer në 07.08.2020. Me ardhjen e Vendimit Nr. 167, datë 07.07.2021</p>	Me shkresë zyrtare.	Pa Pagesë.

		<p>apo adresën elektronike të poshtëshënuar. Dite te mbare! Dallandyshe Xhaferri, nr.cel: 0686214492</p>		<p>të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kanë filluar procedurat për kalimin në favor të shtetit. Pas kalimit në favor të shtetit është përgatitur dokumentacioni përkatës së bashku me Raportin Tekniko-Financiar dhe janë dërguar në “Komitetin Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat kundër Krimin të Organizuar” dhe me Vendimin Nr. 67, datë 29.07.2022 ka vendosur shitjen e 33.3%, të pasurisë së sipërcituar pjesë e konfiskuar. Pasuria e sipërcituar ka dalë në ankand vetëm njëherë, por nuk ka pasë asnjë shprehje interesi. Gjëndja e keqe dhe amortizimi që kjo pasuri ka nuk e ka lejuar dhënien me qera.</p>		
--	--	--	--	--	--	--